



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 414/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.10.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

- Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MC Networking” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-64772-07-08-2020, me objekt “Blerje Shërbimi të Zhvillimit të Mirëmbajtjes së Programit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Webservice-ve”, me fond limit 5.760.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.
- Ankimues:** “MC Networking” sh.p.k.
Rruga “Pjetër Bogdani”, Godina Nr.3, Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë
Rruga e Kavajës, ish Uzina Mekanike, Hyrja 203, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-64772-07-08-2020, me objekt “*Blerje Shërbimi të Zhvillimit të Mirëmbajtjes së Programit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Webservice-ve*”, me fond limit 5.760.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.

II.2. Në datën 27.07.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në

datë 29.07.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MC Networking” sh.p.k. 5.200.000 lekë, skualifikuar
2. “Datech” sh.p.k. 5.700.000 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 29.07.2020 operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

Nuk permbush piken 2.3 Për kapacitetin teknik: Përvojë e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme në një vlerë të paktën prej 40% të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit

- *Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore Operatori ekonomik duhet ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate*

- *Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të nënshkruara nga të dyja palët ku të shprehen qartë datat shumë dhe shërbimet e realizuara*

Pasi kontrata nr.174 date 11.07.2019 nuk ka natyre të ngjashme me objektin e prokurimit "Blerje Shërbimi të Zhvillimit të Mirëmbajtjes së Programit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Ëëbservice-ve" Kontrata është për sistem administrimi rradhe dhe objekti i prokurimit është për zhvillim dhe mirembajtje sistem financiar (sistem taksash)

KVO gjithashtu konstaton se kontrata nr.174 date 11.07.2019 është jo e plote (mungon aneksi 2 dhe 3 të cituar në kontrate) dhe për pasojë e pavlefshme, pasi tek neni 1 citon se kontrata është Kontrata + anekset bashkelidhur. me poshtë, tek neni 2, pika 2.1 citon se kontrata ka edhe aneksin 1, 2 dhe 3 për të dhënat teknike, sasine dhe cmimet.

II.5. Në datën 04.08.2020 operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]

Ne lidhje me procedurën e prokurimit të shërbimit me nr. reference REF-64772-07-08-2020 për "Blerje shërbimi të zhvillimit të mirembajtjes së programit të taksave dhe tarifave vendore dhe Ëëbservice-ve", të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tirane me vlerë të perllogaritur 5.760.000,00 në paraqitjen e ofertës. Lidhur me të, autoriteti kontraktor na informoi se oferta jone është refuzuar për shkakun e vetëm se sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave: "Kontrata nr.174, date 11.07.2019 nuk ka natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit "Blerje shërbimi të zhvillimit të mirembajtjes së programit të taksave dhe tarifave vendore dhe Ëëbservice-ve". Kontrata është për sistem administrimi rradhe dhe objekti i prokurimit është për zhvillim dhe mirembajtje sistemi financiar (sistem taksash). Kontrata nr.174, date 11.07.2019 është jo e plote (mungon aneksi 2 dhe 3 të cituara në kontrate) dhe për pasojë e pavlefshme pasi tek neni 1 citon se Kontrata është kontrata + anekset

bashkelidhur, me poshte tek neni 2, pika 2.1 citon se kontrata ka dhe aneksin 1, 2 dhe 3 per te dhenat teknike, sasine dhe cmimet."

Nje vleresim i tille eshte ne kundershitim me parashkimet e sipercituara te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe me ato te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar.

Se pari, ne lidhje me provimin e pasjes nga operatoret ekonomik pjesemarres ne procedurat e prokurimit te "sherbimeve te ngjashme" te realizuar ne sektorin privat Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne piken 3 te nenit 28 te tij parashikon se autoriteti kontraktor pranon si deshmi si deshmi pranohen "vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara." Gjithshtu, ne te njejten menyre, dokumentat e tenderit ne piken 2.3 te tyre, me titull "Per kapacitetin teknik", parashikojne: "Pervoje e suksesshme ne kryerjen e sherbimeve me natyre te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 40 % te fondit limit qe prokurohet, te realizuara gjate tre viteve te fundit te aktivitetit te operatorit. Kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me institucione shteterore Operatori ekonomik duhet ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar nga institucioni shteteror per realizimin e plote dhe te suksesshem te kesaj kontrate. Kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me subjekte private Operatori ekonomik duhet ta vertetoje kete sherbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese te nenshkruara nga te dyja palet ku te shprehen qarte datat shumat dhe sherbimet e realizuara."

Bazuar ne keto parashikime, sqarojme se ne si operator ekonomik, pjesemarres ne kete procedure prokurimi, nuk kishim asnje detyrim te paraqisnim kontraten e ngjashme te lidhur ne sektorin privat, por vetem "vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara." Si rrjedhoje, KVO lidhur me provueshmerine nga ne te pasjes se "sherbimeve te ngjashme" duhet te ishte bazuar vetem te vleresimi i faturave tatimore te shitjes, te vendosura prej nesh ne dispozicion me paraqitjen e ofertes, Paraqitja prej nesh e kontrates se ngjashme te lidhur me sektorin privat (konkretisht me Banken Credins SHA) me nr.174, date 11.07.2019 me objekt "Analize, Zhvillim, Konfigurim, Huaperdorje dhe mirembajtje per sistemin e e administrimit te rradhes QMS" ka qene nje dokument shtese i paraqitur nga ne, pa u kerkuar nga ligji, VKM, apo dokumentat e tenderit. Me fjale te tjera, paraqitja apo jo prej nesh e kontrates se ngjashme apo anekseve te saj ne kuptim te kuadrit juridik rregullator te kesaj procedure prokurimi nuk mund te perbeje shkak per refuzimin e ofertes tone.

Se dyti, Kvo ben nje vleresim te gabuar te kriterit te pasjes se "sherbimeve te ngjashme" kur shprehet se Kontrata nr.174, date 11.07.2019 me objekt "Analize, Zhvillim, Konfigurim, Huaperdorje dhe mirembajtje per sistemin e administrimit te rradhes QMS" e lidhur mes nesh dhe subjektit privat "Banka Credins" SHA nuk ka natyre te ngjashme me objektin e prokurimit "Blerje sherbimi te zhvillimit te mirembajtjes se programit te taksave dhe tarifave vendore dhe Eëbserviceve", per shkak se kontrata e paraqitur prej nesh ka qene sipas komisionit "per administrim rradhe", ndersa objekti i procedures se prokurimit ne fjale eshte per "zhvillim dhe mirembajtje sistemi financiar (sistem taksash)". Si objekti i kontrates se paraqitur prej nesh, edhe objekti i procedures se prokurimit jane te ngjashme per shkak se te dyja kane te bejne me sherbim mirembajtje, zhvillimi (etj) sistemi. Kriteri "sherbime te ngjashme" nuk mund te interpretohet si sherbime te njejta dhe si rrjedhoje oferta jone te refuzohet sepse pavaresisht se kemi sherbime te ngjashme ne mirembajtjen,

menaxhimin, zhvillimin e sistemit të administrimit të rradhes, nuk kemi shërbime të mëparshme në zhvillimin, mbirembajtjen e një sistemi financiar.

KVO ka bërë interpretim tërësisht abuziv dhe sipërfaqësor të kriterit të kërkuar për përvojë të ngjashme. KVO gjatë shqyrtimit të ofertave nuk mund të krahasojë vetëm emertesen e objektit të kontratës apo tipin, llojin e kontratës (mallra apo shërbime). Kriteret për kualifikim të shërbjeve autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e aseteve të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zoteron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me fushën e veprimtarisë së objektit të prokurimit, por, edhe në përputhje me volumin dhe përkatësitë të dokumentatave të tenderit. Kjo do të thotë se, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në thellësi dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatet, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përkatësitë, E kundërt në vetvete nënkupton eksperiencat e njëjta apo zëra të njëjta të shërbimeve apo mallrave dhe hie në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përkatësitë në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të tyre në procedurat e prokurimit publik.

Te njëjtin vlerësim lidhur me interpretimin e pasjes së eksperiencës në "shërbime të ngjashme" ka bërë edhe Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.423/2019: "KPP gjykon se për të plotësuar pikën e mesipërme të kërkesave për kualifikim për kontratat e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat e ngjashme me objektin që prokurohet dhe jo kontratat e njëjta, pasi në këtë rast do të qëheshin kontratat e njëjta ato kontratat që përmbajnë të gjitha zërat që përmban preventivi i shërbimeve që tenderohen, gjë e cila është pothuajse e pamundur, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zoteron eksperiencat e mëparshme të ngjashme, brenda fushës së ekspertizës me shërbimet objekt prokurimit, që në rastin konkret lidhen me teknologjinë e informacionit dhe elektronikës. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbjeve autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varesi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përçakton kërkesat e vecanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Pra, mbështetur në sa më sipër, Autoriteti Kontraktor, haptazi në refuzimin e ofertës tone, nuk ka zbatuar parashikimet juridike në fuqi.

II.6. Autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.20884/25 prot., datë 10.08.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes duke e refuzuar atë me argumentimin si më poshtë:

[...]

Autoriteti Kontraktor mori në shqyrtim ankesën tuaj e cila lidhet me skualifikimin nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt:

"Blerje Sherbimi te Zhvillimit te Mirembajtjes se Programit te Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Eëbservice-ve ", zhvilluar ne daten 27.07.2020.

Arsyeja e skualifikimit lidhet me mosplotesimin e kerkesave per kualifikimin nga shoqeria Juaj, konkretisht per pune te ngjashme sikurse eshte kerkuar ne DST (Kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.3 "Kapaciteti teknik"). Ne lidhje me pretendimin e parashtruar ne ankesen Tuaj, konkretisht, per kontrata te ngjashme te realizuara ne sektorin privat, shprehimisht citoni se: "Si objekti I kontrates se paraqitur prej nesh dhe objekti i procedures se prokurimit Jane te ngjashme per shkak se te dyja kane te bejne me sherbimin e mirembajtjes, zhvillimi (etj) sistemi. Kriteri "sherbime te ngjashme" nuk mund te interpretohet si sherbime te njejta dhe si rrjedhoje oferta jone te refuzohet sepse pavaresisht se kemi sherbime te ngjashme ne mirembajtjen, menaxhimin, zhvillimin e sistemit te administrimit te radhes, nuk kemi sherbime te meparshme ne zhvillimin, mirembajtjen e nje sistemi financiar".

Sa me siper referuar nenit 28 pika 1 dhe pika 3, e VKM-se Nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, ne te cilin parashikohet shprehimisht se: "Natyra e sherbimeve duhet te shprehet qarte ne termat e references, ku perfshihen objekti, qellimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore te sherbimit qe do te kryhet" si dhe pikes 3 te nenit te cila parashikon shprehimisht se: "Per te provuar pervojen e meparshme, autoriteti kontraktor kerkon deshmi per sherbimet e meparshme, te ngjashme, te kryera gjate tri viteve te fundit. Ne cdo rast, vlera e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te madhe se 40 % te vleres se perllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit. Autoriteti kontraktor si deshmi per pervojen e meparshme kerkon vertetime te leshuara nga nje ent publik ose/dhe faturave tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara. Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara ".

Ne vijim ne nenin 46, pika 1, germa "b" te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: [...]

Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: [...]

Komisioni, referuar ne menyre specifike objektit te prokurimit, kriterete te percaktuara nga Autoriteti Kontraktor si dhe specifikimeve teknike, Komisioni gjykon se ato ne teresine e tyre shprehin qarte kerkesen e autoritetit kontraktor per natyren e sherbimit objekt prokurimi, i cili ne rastin konkret nuk ka te beje thjesht me nje sistem menaxhimi te radhes i cili konkretisht realizon vetem administrimin e radhes per individet te cilet kerkojne nje sherbim te caktuar prane institucioneve shteterore apo shoqerive private, por kemi te bejme me nje proces i cili eshte shume here me kompleks ne lidhje me sherbimin, zhvillimin dhe mirembajtjen e tij, pasi ka te beje me nje sistem kompleks financiar.

Ne analize te te gjitha dokumentacionit te paraqitur ne permbushje te kriterit per "pervoje e sukseshme ne kryerjen e sherbimeve me natyre te ngjashme", Komisioni gjykon se faturat e paraqitura nuk mund te konsiderohen sherbime te ngjashme pasi nuk permbajne karakteristiken dhe specifikun e kerkuar nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit per menyren e realizimit te ketij sherbimi (sherbim te zhvillimit dhe mirembajtjes se sistemit te taksave dhe tarifave vendore dhe eëbservice-ve).

Kjo kontrate deshmon vetem eksperiencen tuaj si Operatorit Ekonomik per realizimin e sherbimit te zhvillimit te mirembajtjes se sistemit te radhes, por jo per sherbimin specifik te kerkuar dhe te

percaktuar qarte si ne objektin e prokurimit ashtu edhe ne specifikimet teknike. Kriteret kualifikuese te percaktuara nga autoriteti kontraktor jane te detyrueshme per t'u permbushur nga te gjitha ofertuesit ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi.

Autoriteti Kontraktor konsideron te vlefshme nje oferte, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit. Mosplotesimi qofte edhe i nje kriteri te vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor e ben oferten e Operatorit Ekonomik te pavlefshme.

Ne rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e Operatorit Ekonomik nuk perrmbush kerkesen e Autoritetit Kontraktor per kontrata te ngjashme me objektin e prokurimit per zhvillimin dhe mirembajtjen e programit te taksave vendore dhe ëbserviceve, sipas dokumentave te tenderit te publikuara nga autoriteti kontraktor.

Referuar ne menyre specifike objektit te prokurimit: "Blerje Sherbimi te Zhvillimit te Mirembajtjes se Programit te Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Ëbservice-ve ", kriterete te percaktuara nga Autoriteti Kontraktor si dhe specifikimeve teknike, ne gjykojme se ato ne teresine e tyre shprehin qarte kerkesen e autoritetit kontraktor per natyren e sherbimit objekt prokurimi, i cili ne rastin konkret ka te beje me sherbimin, zhvillimin dhe mirembajtjen e programit te taksave dhe tarifave vendore si dhe ëbservice-ve. Si rrjedhoje komisioni me ane te fatures tatiomre, nuk arrin te vleresoje cfare sherbimesh/punesh keni realizuar konkretisht me subjektin privat apo shteteror. Gjithashtu ngjashmeria midis atyre cfare kerkon Autoriteti Kontraktor dhe kontratave te ngjashme, varjon nga 0% (qe nuk ka asnje perputhshmeri) deri ne 100% (qe jane identike).

Me aq sa dokumenta, Ju si Operator Ekonomik keni dorezuar ne APP, duke ditur sherbimet/punet qe duhet te kryhen per zhvillimin dhe mirembajtjen e sistemit te taksave dhe sherbimet/punet cfare Ju keni kryer per mirembajtjen e sistemit te manaxhimit te rradhes prane sektorit privat. Komisioni i Vleresimit te Ofertave, me te drejte nuk ka gjetur asnje perputhje mes zhvillimit dhe mirembajtjes se nje sistemi financiar kompleks sic eshte Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nje "Sistem Manaxhim Rradhe" qe ju e paraqisni si kontrate te ngjashme te kryer ne sektorin privat krahasuar me objektin e prokurimit dhe specifikimet teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

E ngjashme do ishte nese ju do te kishit zhvilluar dhe mirembajtur nje sistem financiar (aty do te gjenim ngjashmeri mbi 50% dhe do te ishte kontrate e pranueshme). Per nga rendesia, permasat dhe impakti publik, Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore krahasohet me sistemin e tatimeve, risku qe mbart mungesa e eksperiences nga ana Juaj per te zhvilluar dhe mirembajtur kete sistem do te ishte ne permasa te pallogaritshme demi per Autoritetin Kontraktor.

Pervec kesaj, ashtu sic dhe Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka konstatuar, kontrata nuk eshte e plote (gje per te cilen ju nuk keni kundershuar), Komisioni nuk arrin te evidentojte nese sherbimi qe keni kryer per sektorin privat te kete ngjashmeri me llojin e sherbimit qe kerkohet ne objektin e prokurimit dhe specifikimet teknike nga Autoriteti Kontraktor, pasi ne faturen e paraqitur nuk eshte shprehur qarte dhe me hollesi cdo sherbim qe eshte kryer nga ana Juaj prane ketij subjekti privat.

Ne kete kuptim, per Autoritetin Kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron eksperiencat e meparshme te ngjashme me objektin e prokurimit dhe ne perputhje me volumn e percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Sa me siper Autoriteti Kontraktor vendosi te mos pranoje ankesen Tuaj per procedure e prokurimit "Kerkese per Propozim/Marreveshje kuader me objekt: "Blerje Sherbimi Zhvillimit te Mirembajtjes se Programit te Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Ëbservice-ve", me fond limit:

5, 760.000 (pese milion e shtateqind e gjashtedhete mije) leke pa TVSH, zhvilluar ne daten 27.07.2020.

II.7. Në datën 19.08.2020 operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjta pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Konkretisht operatorit ekonomik ankimes pretendon:

[...]

Ne lidhje me proceduren e prokurimit te sherbimit me nr. reference REF-64772-07-08-2020 per "Blerje sherbimi te zhvillimit te mirembajtjes se programit te taksave dhe tarifave vendore dhe Eëbservice-ve", te zhvilluar nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tirane me vlere te perlllogaritur 5.760.000,00 ne paraqitem oferten tone. Lidhur me te, autorteti kontraktor na informoi se oferta jone eshte refuzuar per shkakun e vetem se sipas vleresimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave: "Kontrata nr.174, date 11.07.2019 nuk ka natyre te ngjashme me objektin e prokurimit "Blerje sherbimi te zhvillimit te mirembajtjes se programit te taksave dhe tarifave vendore dhe Eëbservice-ve". Kontrata eshte per sistem administrimi rradhe dhe objekti i prokurimit eshte per zhvillim dhe mirembajtje sistemi financiar (sistem taksash). Kontrata nr.174, date 11.07.2019 eshte jo e plote (mungon aneksi 2 dhe 3 te cituara ne kontrate) dhe per pasoje e pavlefshme pasi tek neni 1 citon se Kontrata eshte kontrata + anekset bashkelidhur, me poshte tek neni 2, pika 2.1 citon se kontrata ka dhe aneksin 1, 2 dhe 3 per te dhenat teknike, sasine dhe cmimet."

Nje vleresim i tille eshte ne kundërshtim me parashkimet e sipercituara te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe me ato te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar.

Se pari, ne lidhje me provimin e pasjes nga operatorët ekonomik pjesëmarrës ne procedurat e prokurimit te "sherbimeve te ngjashme" te realizuar ne sektorin privat Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne piken 3 te nenit 28 te tij parashikon se autoriteti kontraktor pranon si deshmi si deshmi pranohen "vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara." Gjithshtu, ne te njejten menyre, dokumentat e tenderit ne piken 2.3 te tyre, me titull "Per kapacitetin teknik", parashikojne: "Pervoje e suksesshme ne kryerjen e sherbimeve me natyre te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 40 % te fondit limit qe prokurohet, te realizuara gjate tre viteve te fundit te aktivitetit te operatorit. Kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me institucione shteterore Operatori ekonomik duhet ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar nga institucioni shteteror per realizimin e plote dhe te sukseshem te kesaj kontrate. Kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me subjekte private Operatori ekonomik duhet ta vertetoje kete sherbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese te nenshkruara nga te dyja palet ku te shprehen qarte datat shumat dhe sherbimet e realizuara."

Bazuar ne keto parashikime, sqarojme se ne si operator ekonomik, pjesëmarrës ne kete procedure prokurimi, nuk kishim asnje detyrim te paraqisnim kontraten e ngjashme te lidhur ne sektorin privat, por vetem "vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara." Si rrjedhoje, KVO lidhur me provueshmerine nga ne te pasjes se "sherbimeve te ngjashme" duhet te ishte bazuar vetem te vleresimi i faturave tatimore te shitjes, te vendosura prej

nesh ne dispozicion me paraqitjen e ofertes, Paraqitja prej nesh e kontrates se ngjashme te lidhur me sektorin privat (konkretisht me Banken Credins SHA) me nr.174, date 11.07.2019 me objekt "Analize, Zhvillim, Konfigurim, Huapendorje dhe mirembajtje per sistemin e administrimit te rradhes QMS" ka qene nje dokument shtese i paraqitur nga ne, pa u kerkuar nga ligji, VKM, apo dokumentat e tenderit. Me fjale te tjera, paraqitja apo jo prej nesh e kontrates se ngjashme apo anekseve te saj ne kuptim te kuadrit juridik rregullator te kesaj procedure prokurimi nuk mund te perbeje shkak per refuzimin e ofertes tone.

Se dyti, Kvo ben nje vleresim te gabuar te kriterit te pasjes se "sherbimeve te ngjashme" kur shprehet se Kontrata nr.174, date 11.07.2019 me objekt "Analize, Zhvillim, Konfigurim, Huapendorje dhe mirembajtje per sistemin e administrimit te rradhes QMS" e lidhur mes nesh dhe subjektit privat "Banka Credins" SHA nuk ka natyre te ngjashme me objektin e prokurimit "Blerje sherbimi te zhvillimit te mirembajtjes se programit te taksave dhe tarifave vendore dhe Eëbserviceve", per shkak se kontrata e paraqitur prej nesh ka qene sipas komisionit "per administrim rradhe", ndersa objekti i procedures se prokurimit ne fjale eshte per "zhvillim dhe mirembajtje sistemi financiar (sistem taksash)". Si objekti i kontrates se paraqitur prej nesh, edhe objekti i procedures se prokurimit jane te ngjashme per shkak se te dyja kane te bejne me sherbim mirembajtje, zhvillimi (etj) sistemi. Kriteri "sherbime te ngjashme" nuk mund te interpretohet si sherbime te njejta dhe si rrjedhoje oferta jone te refuzohet sepse pavaresisht se kemi sherbime te ngjashme ne mirembajtjen, menaxhimin, zhvillimin e sistemit te administrimit te rradhes, nuk kemi sherbime te meparshme ne zhvillimin, mbirembajtjen e nje sistemi financiar.

KVO ka ber interpretim teresisht abuziv dhe siperfaqesor te kriterit te kerkuar per pervoje te ngjashme. KVO gjate shqyrtimit te ofertave nuk mund te krahasoje vetem emertesën e objektit te kontrates apo tipin, llojin e kontrates (mallra apo sherbime). Kriteret per kualifikim i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asetete tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron eksperiencat e meparshme te ngjashme me fushen e veprimtarise se objektit te prokurimi por, edhe ne perputhje me volumin e percaktuar ne dokumentat e tenderit. Kjo do te thote se, autoriteti kontraktor nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale, por te analizoje ne themel dhe ne menyre te arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatet, ne funksion te qellimit dhe rrethanave faktike per te cilin vendosen kriteret e percaktuara, E kunderta ne vetvete nenkupton eksperienca te njejta apo zera te njejte te sherbimeve apo mallrave dhe hie ne kundersizim edhe me vete frymen dhe qellimin e ligjit te percaktuara ne nenin 1 te tij, duke frenuar konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomik dhe duke bere nje trajtim jo te barabarte dhe diskriminues te tyre ne procedurat e prokurimit publik.

Te njejtin vleresim lidhur me interpretimin e pasjes eksperiences ne "sherbime te ngjashme" ka bere edhe Komisioni i Prokurimi Publik me vendimin nr.423/2019: "KPP gjykon se per te plotesuar piken e mesiperme te kerkesave per kualifikim per kontratat e ngjashme, operatoret ekonomik duhet te paraqesin kontrata te ngjashme me objektin qe prokurohet dhe jo kontrata te njejta, pasi në kete rast do te quheshin kontrata te njejta ato kontrata qe permbajne te gjitha zerat qe permban preventivi i sherbimeve qe tenderohen, gie e cila eshte pothuajse e pamundur, pasi

per autoritetin kontraktor eshte e rëndesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron eksperiencat e meparshme te ngjashme, brenda fushes se ekspertizes me sherbimet objekt prokurimi, qe ne rastin konkrete lidhen me teknologjine e informacionit dhe elektronikes. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit ekonomik per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit.

Pra, mbeshtetur ne sa me sipër, Autoriteti Kontraktor, haptazi ne refuzimin e ofertes tone, nuk ka zbatuar parashikimet juridike ne fuqi.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 20884/28 prot., datë 28.08.2020, protokolluar me tonën në datën 31.08.2020, me objekt “Dërgim informacioni, në zbatim të Vendimit Nr.991/1 Prot., datë 20.08.2020, të KPP-së për procedurën e prokurimit me Nr.Ref-64772-07-08-2020, me objekt: “Blerje Shërbimi të Zhvillimit të Mirëmbajtjes së Programit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Ëëbservice-ve”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MC Networking” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “Nuk permbush piken 2.3 Për kapacitetin teknik: Përvojë e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme në një vlerë të paktën prej 40% të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit

• Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore Operatori ekonomik duhet ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate. • Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të nënshkruara nga të dyja palët ku të shprehen qartë datat shumë dhe shërbimet e realizuara. Pasi kontrata nr.174 date 11.07.2019 nuk ka natyre te ngjashme me objektin e prokurimit "Blerje Shërbimi të Zhvillimit të Mirëmbajtjes së Programit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Ëëbservice-ve" Kontrata eshte per sistem administrimi rradhe dhe objekti i prokurimit eshte per zhvillim dhe mirembajtje sistem financiar (sistem taksash). KVO gjithashtu konstaton se kontrata nr.174 date 11.07.2019 eshte jo e plote (mungon aneksi 2 dhe 3 te cituar ne kontrate) dhe per pasoje e pavlefshme, pasi tek neni 1 citon se kontrata eshte Kontrata + anekset bashkelidhur. me poshte, tek neni 2, pika 2.1 citon se

kontrata ka edhe aneksin 1, 2 dhe 3 per te dhenat teknike, sasine dhe cmimet. [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, pika 2.3 “Për Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

1. Përvojë e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme në një vlerë të paktën prej 40% të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore Operatori ekonomik duhet ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.
- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të nënshkruara nga të dyja palët ku të shprehen qartë datat shumë dhe shërbimet e realizuara.
 - a) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 7 vjet përvojë në fushën e teknologjisë se informacionit. Kjo duhet të vërtetohet me:
 - Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar të Operatorit Ekonomik lëshuar nga QKB
 - Profili (CV) i Operatorit Ekonomik.

III.1.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, pika 2.3 është modifikuar si më poshtë:

2.3 Për kapacitetin teknik:

Përvojë e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme në një vlerë të paktën prej 40% të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit.

Për kapacitetin teknik, pika 2.3

a) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 7 vjet përvojë në fushën e teknologjisë se informacionit. Kjo duhet të vërtetohet me:

- Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar të Operatorit Ekonomik lëshuar nga QKB
- Profili (CV) i Operatorit Ekonomik

Të modifikohen në:

2.3 Për kapacitetin teknik:

Përvojë e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme në një vlerë të paktën prej 40% të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit, deri në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Për kapacitetin teknik, pika 2.3

a) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 7 vjet përvojë në fushën e teknologjisë se informacionit. (Hiqet si kriter)

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k., ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

1. Faturë Tatimore Shitje nr.1252, datë 31.12.2019, ndërmjet shitësit “MC Networking” sh.p.k. dhe blerësit “Banka Credins” sh.a. me vlerë 250 000 euro.

2. Faturë Tatimore Shitje nr.1246, datë 30.12.2019, ndërmjet shitësit “MC Networking” sh.p.k. dhe blerësit “Banka Credins” sh.a. me vlerë 105 000 euro.
3. Faturë Tatimore Shitje nr.1147, datë 30.11.2019, ndërmjet shitësit “MC Networking” sh.p.k. dhe blerësit “Banka Credins” sh.a. me vlerë 240 000 euro.
3. Kontratë nr. prot. 174, Prot. Nr.38382, lidhur ndërmjet Banka Credins sh.a. dhe operatorit ekonomik “MC Networking” sh.p.k. me objekt: “Analize, zhvillim, konfigurim, personalizim, huapërdorim dhe mirembajtje për sistemin e administrimit të radhës (QMS) sipas përcaktimeve, sasive dhe çmimeve të përshkruara në Aneksin 1, Aneksin 2 dhe Aneksin 3 bashkëlidhur kësaj kontrate”. Gjithashtu bashkëlidhur kësaj kontrate operatori ekonomik ankimes ka paraqitur Aneksi 1 “Lista e produkteve” dhe e vlerave për këto produkte.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.5. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.6. Neni 27, pika 4 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon: *“4.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.”

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në pikën 2.3. të Kapacitetit teknik autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka përvojë të suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme në një vlerë të paktën prej 40 % të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit deri në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate. Kur shërbimi i ngjashëm është

realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të nënshkruara nga të dyja palët ku të shprehen qartë datat shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur Faturë Tatimore Shitje nr.1252, datë 31.12.2019, ndërmjet shitësit “MC Networking” sh.p.k. dhe blerësit “Banka Credins” sh.a. me vlerë 250 000 euro; Faturë Tatimore Shitje nr.1246, datë 30.12.2019, ndërmjet shitësit “MC Networking” sh.p.k. dhe blerësit “Banka Credins” sh.a. me vlerë 105 000 euro; Faturë Tatimore Shitje nr.1147, datë 30.11.2019, ndërmjet shitësit “MC Networking” sh.p.k. dhe blerësit “Banka Credins” sh.a. me vlerë 240 000 euro. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur Kontratë nr. prot. 174, Prot. Nr.38382, datë 11.07.2019 lidhur ndërmjet Banka Credins sh.a. dhe operatorit ekonomik “MC Networking” sh.p.k. me objekt: “Analizë, zhvillim, konfigurim, personalizim, huapërdorim dhe mirëmbajtje për sistemin e administrimit të radhes (QMS) sipas përcaktimeve, sasive dhe çmimeve të përshkruara në Aneksin 1, Aneksin 2 dhe Aneksin 3 bashkëlidhur kësaj kontrate”. Gjithashtu, bashkëlidhur kësaj kontrate operatori ekonomik ankimues ka paraqitur Aneksi 1 “Lista e produkteve” dhe e cmimeve për këto produkte.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ky i fundit, në përmbushje të kriterit të mësipërm, KPP konstaton se, faturat tatimore të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, ndërmjet tij dhe Bankës Credins sh.a. janë nënshkruar nga të dyja palët si dhe përcaktohet vlera e shërbimit, por nuk janë përcaktuar në mënyrë të detajuar shërbimet e realizuara për të cilat janë lëshuar këto fatura, por referojnë në mënyrë të shprehur në kontratën Nr.38382, datë 11.07.2019. Komisioni, nga verifikimi i Kontratës nr. prot. 174, Prot. Nr.38382, datë 11.07.2019, konkretisht Aneksit 1 të saj, në të cilën pasqyrohen Lista e produkteve dhe cmimet e tyre, konstatohet se vlerat e deklaruara në Aneksin 1 nuk përputhen me vlerat e faturave tatimore të nënshkruara për këtë kontratë, pasi vlera e shërbimeve të parashikuara në aneksin 1 të kontratës është disa herë më e ulët se vlera në faturat e paraqitura. Pra, sipas aneksit 1 të kontratës së paraqitur, vlera e parashikuar është disa herë më e ulët se 40% të fondit limit që prokurohet.

Vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka përcaktuar shprehimisht që kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të nënshkruara nga të dyja palët ku të shprehen qartë datat shumat dhe shërbimet e realizuara, por në rastin konkret operatori ekonomik ankimues në faturat e paraqitura nuk ka pasqyruar në mënyrë të detajuar shërbimet e realizuara, por ka paraqitur listën e produkteve në Aneksin 1 të kontratës, në të cilën nuk korrespondojnë vlerat e këtyre produkteve me vlerat e faturave. Sa më sipër, për sa kohë operatori ekonomik ankimues nuk vërteton lidhjen midis faturave të paraqitura dhe listës së shërbimeve sipas kontratës për të cilën janë lëshuar këto fatura, rrjedhimisht kriteri në lidhje me eksperiencën e ngjashme do të konsiderohet i papërmbushur.

III.1.10. Komisioni rithekson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën

e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit sa i takon eksperiencës së ngjashme, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.11. Referuar dokumentacionit sa më sipër, të paraqitur nga operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k, në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor për eksperiencën e ngjashme, konstatohet se, operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k nuk ka përmbushur këtë kriter, pasi nuk vërteton lidhjen midis faturave tatimore të paraqitura dhe Kontratës sipas të cilës janë lëshuar këto fatura.

Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8, pika 2.3. “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.12. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, të ndryshuar. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimin të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte

paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MC Networking” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-64772-07-08-2020, me objekt “Blerje Shërbimi të Zhvillimit të Mirëmbajtjes së Programit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Webservice-ve”, me fond limit 5.760.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 991 Protokolli

Datë 19.08.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri